



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____/____/2026

**PËR
NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KËSHILLIT KULTUROR,
ARTISTIK DHE SPORTIV PËR PERIUdhËN 2026-2028**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturor”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028”; dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Durrës

TË V E N D O S Ë :

1. Miratimin e ngritjes së Këshillit Kulturor, Artistik dhe Sportiv pranë Bashkisë Durrës, me mandat dy vjecar, për periudhën 2026-2028, me përbërje si më poshtë:
 1. Migena Muhaj – Drejtor, Drejtoria Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare
 2. Haig Zacharjan – Kompozitor
 3. Shpresa Beqiraj – Piktore
 4. Aldo Aliaj – Koreograf
 5. Haxhi Rama – Regjisor
 6. Bujar Qesja – Gazetar
 7. Orges Mema – Dirigjent

2. Miratimin e shpërblimit për cdo anëtar të Këshillit në shumën prej 3500 (tremijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit do të përballohet nga fondi i parashikuar në buxhetin vjetor të Bashkisë Durrës.
4. Ky këshill do ketë karakter këshillimor me mandat dy-vjecar dhe do të mbledhet jo më shumë se gjashtë herë në vit.
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 148, datë 28.09.2023 “Për miratimin e krijimit të Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, shfuqizohet.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI,
SPORTE, KOMUNITETE FETARE**

Drejtor


Migena Muhaj



DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtor

Ina Ferra



DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtor

Valbona Qirako



DREJTORIA LIGJORE

Drejtor

Aneida Broshi



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I KULTURËS**

KËSHILLIT BASHKIAK

RELACION

PËR

**NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KËSHILLIT KULTUROR,
ARTISTIK DHE SPORTIV PËR PERIUdhËN 2026-2028**

Këshilli Kulturor është një strukturë konsultative dhe vendimarrëse që funksionon pranë Bashkisë Durrës, në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturor”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028”.

Këshilli organizon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Rregulloren e funksionimit, të miratuar nga Ministria përkatëse me shkresën nr. 8809/1, datë 28.09.2007.

Duke qenë se mandati 2-vjeçar i këtij Këshilli ka përfunduar, propozohet ringritja e Këshillit të ri Kulturor, me përbërje të përditësuar.

Këshilli Kulturor ka rol vendimmarrës për miratimin e kalendarit vjetor të veprimtarive kulturore, artistike, sportive dhe rinore të Bashkisë Durrës, si dhe rol konsultativ për veprimtari të tjera që zhvillohen jashtë këtij kalendarit. Përmes këtij organi sigurohet një proces transparent, profesional dhe gjithëpërfshirës në përzgjedhjen dhe mbështetjen e projekteve me impakt në jetën kulturore, artistike, sportive dhe rinore të qytetit.

Në kuadër të përzgjedhjes së projekteve, Bashkia Durrës publikon në faqen zyrtare thirrjen për aplikim, duke ftuar shoqata kulturore, organizata dhe individë të fushave përkatëse të paraqesin projekt-propozimet e tyre për t’u bërë pjesë e kalendarit vjetor të aktiviteteve. Interesi i shprehur ndër vite ka reflektuar një larmi të gjerë disiplinash artistike dhe sportive.

Pas miratimit të buxhetit vjetor dhe përcaktimit të fondit për projektet kulturore, Drejtori i Arsimit, Kulturës, Sportit, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare organizon mbledhjen e Këshillit Kulturor, ku paraqiten të gjitha projektet e depozituara për shqyrtim dhe vendimarrje.

Këshilli mbledhet jo më shumë se gjashtë herë në vit dhe drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Sportit, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare.

Anëtarët e Këshillit Kulturor shpërblehen sipas vendimit të Këshillit Bashkiak me shumën prej 3.500 (tremijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje, deri në gjashtë mbledhje në vit.

Efektet financiare përballohen nga shpenzimet operative (Art. 602) të aparatit të Bashkisë dhe fondi është i parashikuar në buxhetin vjetor.

PËRBËRJA E PROPOZUAR E KËSHILLIT KULTUROR:

- | | | |
|----|-----------------|--|
| 1. | Migena Muhaj | – Drejtor, Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare |
| 2. | Haig Zacharjan | – Kompozitor |
| 3. | Shpresa Beqiraj | – Piktore |
| 4. | Aldo Aliaj | – Koreograf |
| 5. | Haxhi Rama | – Regjisor |
| 6. | Bujar Qesja | – Gazetar |
| 7. | Orges Mema | – Dirigjent |

Sa më sipër, propozohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i ngritjes së Këshillit Kulturor pranë Bashkisë Durrës me përbërjen e sipërcituar.

DREJTORI

Migena Muhaj

